



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 05.11.2018
Dokument parlamentar

R A P O R T

Mbi projektligjin *“Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur”*.

Drejtuar: Seancës Plenare

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës shqyrtoi në mbledhjen e datës 05.11.2018 në parim, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin *“Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur”*.

I. Qëllimi dhe objektivat e projektligjit:

Projektligji ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP).

Kjo marrëveshje synon intensifikimin e përpjekjeve për gjetjen e personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste në Shqipëri midis datave 29 nëntor 1944 dhe 2 korrik 1991, duke përcaktuar në veçanti rregullat e bashkëpunimit për identifikimin, gjetjen e personave të zhdukur, si dhe për koordinimin e punës me organet kompetente.

Përparësitë që priten nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje lidhen me nevojën e gjetjes së personave të zhdukur, ku palët do të forcojnë bashkëpunimin dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit për këtë qëllim.

Në veçanti, palët do të ndërmarrin masa të përbashkëta, duke bërë të mundur gjetjen e personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste. Gjithashtu, pritet që palët, sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje, të konsultohen me njëra-tjetrën në lidhje me problematikat që mund të lindin gjatë zbatimit të saj.

II. Përmbledhje shpjeguese e projektligjit:

Projektligji është hartuar në përputhje me neneve 78, 83 e 155 të Kushtetutës, si dhe është në harmoni me ligjin nr.43/2016, *“Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”*.

Sipas kësaj marrëveshjes, ICMP-j, e cila do të themelohet në Tiranë, do të krijojë një zyrë shërbimi për gjetjen e personave të zhdukur, duke përdorur metoda tekniko-shkencore të zbulimit e të identifikimit, si dhe shkëmbimin e informacionit me organet kompetente në kuadër të koordinimit të bashkëpunimit, me qëllim realizimin e aktivitetit administrativ.

ICMP-ja do të jetë përgjegjëse financiarisht për ambientet, pajisjet dhe orenditë për përmbushjen efektive të funksioneve të saj si dhe do të gëzojë imunitetet dhe privilegjet e garantuara për të gjitha misionet diplomatike të akredituara në Shqipëri, në përputhje me Konventën e Vjenës.

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë marrëveshje dhe në dokumentet e rregulloret e ICMP-së dhe të personelit, të shpallura në lidhje me kushtet e punësimit të zyrtarëve, në ambiente do të zbatohen ligjet dhe rregulloret e Shqipërisë. ICMP-ja do të informojë menjëherë autoritetet shqiptare për çdo rregullore e rregull ekzistues dhe do të këshillojë Shqipërinë menjëherë për çdo rregullore dhe rregulla të miratuara rishtazi.

Brenda kuadrit të kësaj marrëveshjeje, ICMP-ja mund të punësojë ekspertë të huaj, por edhe ata me shtetësi shqiptare. ICMP-ja merr përsipër trajnimin e ekspertëve, ku mund të organizojnë trajnime të përbashkëta, nëse është e nevojshme. Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin e tyre, autoritetet kompetente të palëve mund të shkëmbejnë ekspertizë nëpërmjet zyrës, lidhur me çështjet e parashtruara në këtë marrëveshje, me qëllim thjeshtësimin dhe harmonizimin e procedurave e të praktikave.

Shkëmbimi i përbashkët i të dhënave personale ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve do të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës dhe atë ndërkombëtar. Shkëmbimi dhe mbrojtja e informacionit të klasifikuar do të kryhet në përputhje me legjislacionin kombëtar e atë ndërkombëtar.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të zyrës është e parashikuar në tërësi në tekstin e marrëveshjes. Krijimi i kësaj zyre nuk do të sjellë mbivendosje me organet e zbatimit të ligjit, pasi qëllimi është rritja dhe forcimi i bashkëpunimit të autoriteteve kompetente të palëve, nëpërmjet evidentimit, gjetjes së personave të zhdukur, shkëmbimit të informacionit, duke përcaktuar mirë detyrat e zyrës, të pavarura nga detyrat e organeve të administratës publike.

III. Përfundime:

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni për Sigurinë Kombëtare duke vlerësuar rëndësinë e kësaj marrëveshjeje, me shumicën e anëtarëve miraton projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi si dhe shprehet dakord për kalimin e këtij pr/ligji në seancë plenare.

Relator

Kryetar

Luan Duzha

Ermonela (Felaj) VALIKAJ